

VENDIM
Nr.6, datë 6.1.1997

PËR VENDOSJEN E TARIFAVE TELEFONIKE LEHTËSUESE PËR SHYTYPIN

Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifat telefonike të përdorimit vetëm për një numër telefonik të akorduar për organet e shtypit qendror e lokal do të jenë të njëjta me tarifat e pajtimtarëve familjarë.
 2. Tarifat e instalimit vetëm për një lidhje të re telefonike për organet e sipërmendura do të jenë të njëjta me atë të një pajtimtari familjar.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi